



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

---

ZL.Anr.19/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoqaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Bashkim Fazliu, Kandidat i Pavarur për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12.10.2025 në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.09.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

**Hedhet poshtë e palejuar** ankesa ZL.Anr.19/2025 e datës 08.09.2025, parashtruar nga Bashkim Fazliu, Kandidat i Pavarur për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12.10.2025.

#### A r s y e t i m

Me datën 08.09.2025 Kandidati i Pavarur Bashkim Fazliu, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin ka theksuar se me datë 12.08.2025 është certifikuar nga KQZ si Kandidat i Pavarur për Zgjedhjet Lokale 2025 për Kuvendin e Ferizajt. Parashtruesi i ankesës thekson se me datë 07.09.2025, ka shkarkuar nga faqja e KQZ-së, fletëvotimin për Kuvendin e Ferizajt, me c'rast ka vërejtur një lëshim teknik ku vetëm emri i tij ishte shkruar ndryshe nga të tjerët, përkatësisht emri i tij ishte shkruar me të vogla Bashkim Fazliu, në vend se të shkruhej me shkronja të mëdha BASHKIM FAZLIU, sikur emrat e tjerë, ashtu që i ka shkruar KQZ-së që ta rregullojnë këtë lëshim. Ankuesi ka shtuar se kërkesa e tij është e bazuar edhe në Rregulloren e KQZ-së, Nr.10/2024, "Fletëvotimet dhe broshurat", nenin 6 pika 3 ku ka shtuar "DITZ, sigurohet që paraqitja e të dhënave të subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim dhe në broshurë, hapësira për secilin subjekt politik, madhësia dhe tipi i shkronjave të tekstit dhe numrave, si dhe madhësia e logos të jenë të barabarta", si dhe duke u bazuar në nenin 87 paragrafi 1 i Ligjit për

Zgjedhje të Përgjithshme 08/L-228. Kështu ka kërkuar nga PZAP që të përmirësohet formati i fletëvotimit për Kuvendin Komunal në Ferizaj dhe emri i tij të shkruhet me shkronja të mëdha.

PZAP, me datë 08.09.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, lidhur me ankesën ZL.A.nr 19/02025 të parashtruar nga ankuesi Kandidat i Pavarur Bashkim Fazliu. KQZ me datë 09.09.2025, ka parashtruar në PZAP, përgjigje në ankesë në të cilën theksohet se: Procesi i aplikimit për certifikim është proces i rregulluar me nenin 16 të LZP si dhe tutje i zbërthyer në Rregulloren Zgjedhore 04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve. Në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, njëri prej hapave të parë me rastin e aplikimit për certifikim është deklarimi i emrit të subjektit politik, që në rastin e kandidatëve të pavarur është emri i tyre ligjorë. Tutje kanë shtuar se Zyra i procesin të gjitha aplikimet dhe rekomandon KQZ për certifikimin e të gjitha subjekteve politike me emrin që kanë aplikuar për certifikim dhe se kjo nënkupton që Zyra nuk ndryshon as formatin e shkronjave të përdorura nga subjektet politike, duke shtuar se aplikime me formate të ndryshme të shkronjave ka pasur edhe nga subjektet tjera, edhe në zgjedhjet e mëparshme.

Në përgjigje theksohet se në periudhën e aplikimit për certifikim të subjekteve politike për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2025, KQZ u ka mundësuar aplikimin përmes platformës. Përmes kësaj platforme, subjekteve politike u është dhënë mundësia që të përcaktohen emrat në fletëvotime, që përshinë përcaktimin e formatit të shkrimit (shkronja të mëdha si dhe shkronja të vogla). Kanë shtuar se në rastin e kandidatit Bashkim Fazliu, kandidati në fjalë ka aplikuar duke shkruar emrin e tij me shkronja të vogla.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur Vendimin për certifikimin e kandidatit Bashkim Fazliu Nr.01/2066-2025, komunikimet me kandidatin Bashkim Fazliu pas ankesës së tij për emrin, Faqen nga platforma ku shihet se si ka aplikuar kandidati Bashkim Fazliu për certifikim.

Paneli verën se në rastin konkret ankesa e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se *“PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”* Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohet përmirësimi i formati i fletëvotimit, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejueshme.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**ZL.A.nr.19/2025, datë 10.09.2025**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

AA.nr.78/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare, Franciska Zhitija-Ymeri dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Bashkim Fazliu, Kandidat i Pavarur për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, të parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025, në seancën e mbajtur më datë 15.09.2025, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga kandidati i pavarur: Bashkim Fazliu, kandidat për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025, është vendosur: Hedhet poshtë e palejuar ankesa ZL.Anr.19/2025, e datës 08.09.2025, parashtruar nga Bashkim Fazliu, Kandidat i Pavarur për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12.10.2025.

Kundër këtij vendimi kandidati i pavarur për Asamblenë Komunale në Komunën e Ferizajt, Bashkim Fazliu, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Shfuqizojë vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025, dhe të Obligojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që



të korrigojë menjëherë fletëvotimin e emrit të shkruar me shkronja të vogla Bashkim Fazliu duke e paraqitur emrin në fletëvotimin për Asamblenë Komunale Ferizaj, në të njëjtën format si kandidatët tjerë, me shkronja të mëdha, BASHKIM FAZLIU.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e kandidatit të pavarur, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 08.09.2025, Kandidati i Pavarur Bashkim Fazliu, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin ka theksuar se me datë 12.08.2025 është certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), si Kandidat i Pavarur për Zgjedhjet Lokale 2025, për Kuvendin e Ferizajt.

Në ankesën e ushtruar pranë kësaj gjykate kandidati i pavarur thekson se: Me datë 07.09.2025, ka shkarkuar nga faqja e KQZ-së, fletëvotimin për Kuvendin e Ferizajt, me ç'rast ka vërejtur një lëshim teknik ku vetëm emri i tij ishte shkruar ndryshe nga të tjerët, përkatësisht emri i tij ishte shkruar me të vogla Bashkim Fazliu, në vend se të shkruhej me shkronja të mëdha BASHKIM FAZLIU, sikur emrat e tjerë, ashtu që i ka shkruar KQZ-së që ta rregullojnë këtë lëshim. Ankuesi ka shtuar se kërkesa e tij është e bazuar edhe në Rregulloren e KQZ-së, Nr.10/2024, "Fletëvotimet dhe broshurat", nenin 6 pika 3 ku ka shtuar "DITZ, sigurohet që paraqitja e të dhënave të subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim dhe në broshurë, hapësira për secilin subjekt politik, madhësia dhe tipi i shkronjave të tekstit dhe numrave, si dhe madhësia e logos të jenë të barabarta", si dhe duke u bazuar në nenin 87 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme 08/L-228. Kështu ka kërkuar nga PZAP që të përmirësohet formati i fletëvotimit për Kuvendin Komunal në Ferizaj dhe emri i tij të shkruhet me shkronja të mëdha.

PZAP, me datë 08.09.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, lidhur me ankesën ZL.A.nr 19/02025 të parashtruar nga ankuesi Kandidat i Pavarur Bashkim Fazliu.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 09.09.2025, ka parashtruar në PZAP, përgjigje në ankesë në të cilën theksohet se: Procesi i aplikimit për certifikim është proces i rregulluar me nenin 16 të LZP si dhe tutje i zbërthyer në Rregulloren Zgjedhore 04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve. Në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, njëri prej hapave të parë me rastin e aplikimit për certifikim është deklarimi i emrit të subjektit politik, që në rastin e kandidatëve të pavarur është emri i tyre ligjor. Tutje kanë shtuar se Zyra i proceson të gjitha aplikimet dhe rekomandon KQZ për certifikimin e të gjitha subjekteve politike me emrin që kanë aplikuar për certifikim dhe se kjo nënkupton që Zyra nuk ndryshon as formatin e shkronjave të përdorura nga subjektet politike, duke shtuar se aplikime me formate të ndryshme të shkronjave ka pasur edhe nga subjektet tjera, edhe në zgjedhjet e mëparshme. Tutje theksohet se në periudhën e aplikimit për certifikim të subjekteve politike për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2025, KQZ u ka mundësuar aplikimin përmes platformës. Përmes kësaj platforme, subjekteve politike u është dhënë mundësia që të përcaktohen emrat në fletëvotime, që përshinë përcaktimin e formatit të shkrimit (shkronja të mëdha si dhe shkronja të vogla). Kanë shtuar se në rastin e kandidatit Bashkim Fazliu, kandidati në fjalë ka aplikuar duke vene emrin e tij me shkronja të vogla. Andaj, duke u nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura në këtë përgjigje, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse. Për më tepër, ankesa në fjalë konsiderohet e palejuar, pasi nuk bie në kategorinë e vendimeve të KQZ-së, që mund të animohen në PZAP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në tërësi e kundërshton ankesën e paraqitur kundër vendimit ZL.Anr.19/2025, të datës 10.09.2025, duke shtuar se mbeten në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se *“PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”* Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave. Sipas vlerësimit të Panelit, nga



interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohet përmirësimi i formati i fletëvotimit, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të palejueshme ankesën e kandidatit të pavarur, Bashkim Fazliu, kandidat për Asambleenë komunale në Komunën e Ferizaj, për shkak të lëshimit teknik në fletëvotimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Gjykata rikujton se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të ankesës vihet në: shkeljen e nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (par.1 dhe par.3) - e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (par.1 dhe par.2) - barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi, Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme: neni 25 par.4: i cili përcakton se: KQZ siguron që fletëvotimi të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për votuesit, neni 87 par.1: Emrat e kandidatëve paraqiten në fletëvotim si në aplikimin origjinal për certifikim, neni 119 par.3 dhe par.5: PZAP vendos për ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së dhe mund të marrë nën juridiksion çështje për të parandaluar padrejtësi serioze, Rregullorja e KQZ-së Nr. 10/2024, Neni 6 par.3: Parashikon barazi në madhësinë dhe tipin e shkronjave në fletëvotim dhe broshura si dhe Standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme (Dokumenti i Kopenhagenit, OSBE, 1990): të gjithë kandidatët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, megjithatë kolegji i kësaj gjykate i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi si të pathemelta.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i ka vlerësuar të pathemelta dhe të paqëndrueshme, kjo pasi Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme nuk parashikon mundësinë e ankesës lidhur me formatin e fletëvotimit në PZAP, prandaj ankesa me të drejtë është hedhur



poshtë si e palejueshme. Emri i kandidatit është paraqitur sipas aplikimit të tij për certifikim, përfshirë edhe formën e shkronjave, gjë që është procedurë e rregulluar dhe e ndjekur në mënyrë uniforme nga KQZ dhe e përcaktuar edhe në nenin 87 paragraf 1 [Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin], ku përcaktohet se: “1. Emri i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre paraqiten në fletëvotim siç paraqiten në origjinalin e aplikimit për certifikim, subjekt i modifikimeve nëse ka dhe në fund të miratuara nga KQZ-ja”. Shkeljet e pretenduara në aspektin e formatit të shkronjave nuk konsiderohen si shkelje që ndërhyjnë në thelbin e së drejtës për të zgjedhur dhe për të u zgjedhur. Parimet kushtetuese për barazi dhe trajtim të drejtë nuk mund të interpretohen në mënyrë që të ndryshojnë një aspekt teknik të formatimit të emrave në fletëvotim, veçanërisht kur ligji nuk e parashikon këtë si bazë ankese.

Në përmbledhje, pretendimet e kandidatit janë bazuar në nevojën për barazi dhe korrektësi në procesin zgjedhor, por janë refuzuar nga Gjykata Supreme për shkak të kufizimeve ligjore dhe interpretimit të ngushtë të kompetencave të PZAP në lidhje me formatin e fletëvotimit.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.78 /2025 me 15 shtator 2025

Kryetar i kolegjit,

Delushe Halimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës  
 Oznaka spisa:

AA-78/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PLAP

PAISHTI

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrati)

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca ( pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_  
 dana u \_\_\_\_\_ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes \_\_\_\_\_  
 Razlog odbijanja prijmea \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:  
 Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTGJYKIM  
 15.09.2025

Numri i shtojcave: 2  
 broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur  
 më (me fjalë)  
 Poverdujemo prijem gorenavegenog pisma  
 ( i slovima )

Adhucati 15.09.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që  
 e ka marrë aktin në vend të tij  
 Potpis primioaca ili lica koje je  
 pismeno primilo u zamenu) 074  
 19.10

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ajo je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zašto primilac nije stavio svoj potpis.